

RELACION

PËR

PROJEKTVENDIMIN

“PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i projektvendimit “Për miratimin e Rregullore së Planifikimit të Territorit”, është reflektimi i ndryshimeve ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, miratuar me Ligjin Nr. 28/2017, datë 23.03.2017, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, të ndryshuar”, si dhe përmirësimi i kuadrit nënligjor aktual për planifikimin e territorit.

Aktualisht është në fuqi VKM Nr. 671, datë 29.07.2015, “Për miratimin e Rregullore së Planifikimit të Territorit”. Në zbatim të kësaj rregullore janë hartuar disa dokumente planifikimi në nivel qendror dhe vendor:

1. Plani i Përgjithshëm Kombëtar i Territorit;
2. Plani i Integruar Ndërsektorial i Bregdetit;
3. Plani i Integruar Ndërsektorial për Zonën Ekonomike Tiranë-Durrës;
4. 44 Plane të Përgjithshme Vendore, (31 bashki kanë përfunduar procesin e hartimit të PPV, ndërkohë 13 bashki janë në proces hartimi),

Si rrjedhojë e hartimit të dokumenteve sa më sipër, lindi nevoja për ndryshime në Rregulloren e Planifikimit me qëllim përmirësimin e proceseve bashkërenduese dhe teknike në hartimin e planeve.

Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, si autoriteti përgjegjës për bashkërendimin e hartimit të dokumenteve të planifikimit të territorit në nivel qendror e vendor nisi një proces konsultimi me autoritetet përgjegjëse të planifikimit dhe palët e interesuara, mbi nevojat e ndryshimit të Rregullore së Planifikimit.

Gjatë procesit të reflektimit në VKM Nr. 671, datë 29.07.2015, “Për miratimin e Rregullore së Planifikimit të Territorit”, të ndryshimeve të Ligjit 107/2014, i ndryshuar, si dhe propozimeve për ndryshim nga autoritetet përgjegjëse të planifikimit dhe palëve të interesuara, u konstatua se, ndërhyrjet në Rregulloren aktuale të Planifikimit preknin mbi 50% të neneve.

Në këtë situatë, lind nevoja që nga pikëpamja e teknikës legjislativë, reflektimi i ndryshimeve të propozuara në rregulloren aktuale të planifikimit, të trajtohet si hartimi i një rregullore të re.

Si rrjedhojë propozohet për miratim projektvendimi, qëllimi i të cilit është të përmbushë dhe të shtjellojë përcaktimet e Ligjit Nr. 107/2014, i ndryshuar, duke paraqitur rregulla të unifikuara për strukturën, përmbajtjen dhe hapat e hartimit, zbatimit, monitorimit të zbatimit të planeve, me qëllim detajimin e procedurave të planifikimit në nivel qendror dhe vendor dhe arritjen e njëtrajtshmërisë së formës dhe strukturës së dokumenteve të planifikimit.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektvendim është i parashikuar në Programin Analitik të Akteve të Ministrisë së Zhvillimit Urban për vitin 2017.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Akti i propozuar sjell përparësi dhe lehtësi për autoritetet e planifikimit në procesin e bashkërendimit dhe hartimit të dokumenteve të planifikimit. Ky akt synon të thjeshtojë dhe të përcaktojë qartë procedurën e bashkërendimit, hartimit dhe zbatimit të dokumenteve të planifikimit në nivel qendror dhe vendor.

- Ndryshimet ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit (Ligji Nr. 107/2014, “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, ka pësuar ndryshime me miratimin e Ligjit Nr. 28/2017, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, të ndryshuar”), sollën risi të cilat, kanë të bëjnë me:
 1. Regjistri i Integruar i Territorit (RIT), është ndarë në dy degë të veçanta:
 - a. Regjistri Kombëtar i Planifikimit të Territorit;
 - b. Sistemi elektronik e-leje;
 2. Shtimin i konceptit “Zonë Zhvillimi” si pjesë e një njësie strukturore;
 3. Ndryshimin e procedurës së hartimit/miratimit të PDV-së:
 - a. Strategjia territoriale nuk është e nevojshme të hartohet si pjesë e dokumentit të PDV-së, ajo merret si direktivë nga PPV-të;
 - b. Takimet publike nuk janë detyrim ligjor, ato mund të organizohen në rast se kërkohen nga palët e interesuara ose në rast se e vlerëson të nevojshme Kryetari i Bashkisë;
 - c. Dokumenti i PDV-së miratohet vetëm nga Kryetari i Bashkisë dhe nuk kalon për konfirmim në Këshillin Bashkiak.
- Projektvendimi synon të sjellë përmirësime të cilat kanë të bëjnë me:

1. Riorganizimin e renditjes së neneve për çdo seksion;
2. Qartësimin e mënyrave të organizimit dhe funksionimit të Forumit për Bashkërendimin e Planifikimit në Nivel Qendror dhe Vendor;
3. Detajimin sipas fazave të hartimit, të dokumenteve përbërëse të dokumenteve të plota të planifikimit;
4. Asistimin e Agjencisë përgjegjëse për planifikimin e territorit në të gjitha fazat e hartimit të dokumenteve të planifikimit në nivel qendror dhe vendor, duke filluar nga faza e marrjes së Nismës për hartimin e një dokumenti planifikimi e deri tek miratimi dhe zbatimi i dokumentit të plotë të planit.
5. Qartësimin e procedurës për hartimin e PDZRK-së dhe PDV-së;
6. Rikonceptimin e kategorizimit të përdorimit të tokës;
7. Konceptimin e hartimit të standardeve dhe treguesve të planifikimit të territorit në një dokument të veçantë.

IV. KONSULTIMI I PROJEKTAKTIT

Projektvendimi është konsultuar me autoritetet e planifikimit në nivel qendror dhe vendor dhe me ekspertë të fushës në hartimin e dokumenteve të planifikimit.

AKPT, në bashkëpunim me Ministrinë e Zhvillimit Urban ka organizuar konsultime, ku është prezantuar projektvendimi. Janë mbledhur mendime dhe sugjerime, të cilat janë vlerësuar dhe reflektuar në projektvendim.

Konsultimet u organizuan në disa hapa, si më poshtë:

- **Më datë 29.06.2017 – me ekspertë të fushës**, të cilët kanë punuar për hartimin e dokumenteve të planifikimit;
- **Më datë 06.07.2017 – me përfaqësues të bashkive** në proces hartimi të PPV-ve;
- **Më datë 12.07.2017 – me përfaqësues të bashkive**, të cilat kanë përfunduar procesin e hartimit të PPV-ve dhe po i zbatojnë;
- **Më datë 21.07.2017 - me përfaqësues të ministrive dhe agjencive**, fusha e veprimit të të cilave lidhet me planifikimin e territorit;
- **Më datë 18.08.2017 – të gjitha palëve të mësipërme**, u është dërguar projektvendimi me reflektimet e takimeve, për sugjerime të mëtejshme.

V. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Sikurse u përmend më lart, ky akt del si një kërkesë për të reflektuar ndryshimet në legjislacionin në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, si dhe për të përmirësuar më tej, kuadrin nënligjor aktual, me qëllim përmirësimin e proceseve bashkërenduese dhe teknike në hartimin e planeve. Ai është në përputhje me të gjithë legjislacionin kombëtar.

VI. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Nuk aplikohet në këtë rast.

VII. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektvendimi i propozuar mbështetet në nenin 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 6, pika 2, shkronja b), të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014, “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, i cili parashikon se: *“Këshilli i Ministrave është përgjegjës për, miratimin e rregullores së planifikimit, zhvillimit, ndërtimit, rregullores së Regjistrimit Kombëtar të Planifikimit të Territorit si dhe të dokumenteve tjera sipas përcaktimeve të këtij ligji”*

Projektvendimi është konceptuar në 4 (katër) krerë, të ndarë në seksione. Projektvendimi në total përmban 89 nene të strukturuar si më poshtë vijon:

- **Kreu I - Dispozita të Përgjithshme**, në të cilin përfshihen qëllimi i hartimit të këtij projektvendimi dhe përkufizimet për termat e përdorur në të;
- **Kreu II - Dokumentet e Planifikimit**: ku jepen përcaktimet mbi përmbajtjen dhe procesin e hartimit të dokumenteve të planifikimit në nivel qendror dhe vendor, i ndarë në 9 seksione si më poshtë:

1. Seksioni 1 - Dispozita të Përgjithshme, ku jepen përcaktime mbi:

- a. Nismën për hartimin e dokumenteve të planifikimit;
- b. Hartimin e dokumenteve të planifikimit;
- c. Bashkërendimin e dokumenteve të planifikimit;
- d. Këshillimin dhe takimet publike;
- e. Forumin Këshillimor Vendor;
- f. Miratimin e dokumenteve të planifikimit;
- g. Botimin në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit;
- h. Monitorimin e zbatimit të dokumenteve të planifikimit;
- i. Rishikimin e dokumenteve të planifikimit;
- j. Deklaratën e përgjegjësisë profesionale;
- k. Fondi i planifikimit.

2. Seksioni 2 - Hierarkia e Dokumenteve të Planifikimit, ku jepen nivelet e dokumenteve të planifikimit:

- a. Planifikimi në nivel qendror:
 - i. Plani i Përgjithshëm Kombëtar i Territorit (PPKT);
 - ii. Planet Kombëtare Sektoriale (PKS);

- iii. Planet e Detajuara për Zonat e Rëndësisë Kombëtare (PDZRK);
 - b. Planifikimi në nivel vendor:
 - i. Planet Sektoriale në Nivel Qarku (PSNQ);
 - ii. Planet e Përgjithshme Vendore (PPV);
 - iii. Planet Sektoriale në Nivel Bashkie (PSNB);
 - iv. Planet e Detajuara Vendore (PDV).
- 3. Seksioni 3 - Plani i Përgjithshëm Kombëtar i Territorit**, ku përcaktohen:
- a. Objekti i PPKT-së;
 - b. Autoriteti përgjegjës për hartimin e PPKT-së;
 - c. Nisma për hartimin e PPKT-së;
 - d. Përmbajtja e Dokumentit të PPKT-së;
 - e. Miratimi dhe hyrja në fuqi e PPKT-së;
 - f. Zbatimi dhe monitorimi i zbatimit të PPKT-së.
- 4. Seksioni 4 - Plani Kombëtar Sektorial**, ku përcaktohen:
- a. Objekti i PKS-së;
 - b. Autoriteti përgjegjës për hartimin e PKS-së;
 - c. Hartimi, këshillimi dhe bashkërendimi i PKS-së;
 - d. Nisma për hartimin e PKS-së;
 - e. Përmbajtja e dokumentit të PKS-së;
 - f. Miratimi i PKS-së;
 - g. Hyrja në fuqi e PKS-së;
 - h. Zbatimi dhe monitorimi i zbatimit të PKS-së.
- 5. Seksioni 5 - Plani i Detajuar për Zonën me Rëndësi Kombëtare**, ku përcaktohen:
- a. Çështjet, zonat dhe objektet e rëndësisë kombëtare në planifikim;
 - b. Përcaktimi i çështjes, zonës dhe objektit të rëndësisë kombëtare;
 - c. Zhvillimi i zonave të rëndësisë kombëtare në planifikim;
 - d. Objekti i PDZRK-së;
 - e. Aktorët në hartimin e PDZRK-së;
 - f. Hartimi, Bashkërendimi dhe Këshillimi i PDZRK-së;
 - g. Nisma për hartimin e PDZRK-së;
 - h. Përmbajtja e Dokumentit të PDZRK-së;
 - i. Miratimi i PDZRK-së;
 - j. Hyrja në fuqi e PDZRK-së;
 - k. Zbatimi dhe monitorimi i zbatimit të PDZRK-së.
- 6. Seksioni 6 - Plani Sektorial në Nivel Qarku**, ku përcaktohen:
- a. Objekti i PSNQ-së;
 - b. Autoriteti përgjegjës për hartimin e PSNQ-së;
 - c. Hartimi, Këshillimi dhe Bashkërendimi i PSNQ-së;
 - d. Nisma për hartimin e PSNQ-së;

- e. Përmbajtja e dokumentit të PSNQ-së;
- f. Miratimi i PSNQ-së;
- g. Hyrja në fuqi e PSNQ-së;
- h. Zbatimi dhe monitorimi i zbatimit të PSNQ-së.

7. Seksioni 7- Plani i Përgjithshëm Vendor, ku përcaktohen:

- a. Objekti i PPV-së;
- b. Autoriteti përgjegjës për hartimin e PPV-së;
- c. Hartimi, Këshillimi dhe Bashkëndimi i PPV-së;
- d. Nisma për hartimin e PPV-së;
- e. Përmbajtja e dokumentit të PPV-së;
- f. Analiza dhe vlerësimi i territorit;
- g. Strategjia territoriale;
- h. Plani i zhvillimit të territorit;
- i. Rregullorja e planit;
- j. Informacioni gjeohapësinor dhe materiali hartografik i PPV-së;
- k. Hapat për miratimin e PPV-së;
- l. Dokumentet për miratimin e PPV-së;
- m. Procesi i miratimit të PPV-së;
- n. Hyrja në fuqi e PPV-së;
- o. Zbatimi dhe monitorimi i zbatimit të PPV-së.

8. Seksioni 8 - Plani Sektorial në Nivel Bashkie, ku përcaktohen:

- a. Objekti i PSNB-së;
- b. Procedurat e PSNB-së.

9. Seksioni 9 - Plani i Detajuar Vendor, ku përcaktohen:

- a. Objekti dhe qëllimi i PDV-së;
- b. Autoriteti përgjegjës për PDV-në;
- c. Hartimi dhe Këshillimi i PDV-së;
- d. Përmbajtja e Dokumentit të PDV-së;
- e. Miratimi dhe hyrja në fuqi e PDV-së;
- f. Zbatimi dhe monitorimi i zbatimit të PDV-së.

➤ **Kreu III - Drejtime Kryesore në Procesin e Planifikimit,** ku përcaktohet strukturimi dhe zonimi i territorit për qëllime planifikimi dhe zhvillimi, dhe përmban një seksion, si më poshtë:

1. Seksioni 1 – Strukturimi dhe Zonimi i Territorit për Qëllime Planifikimi dhe Zhvillimi, ku përcaktohen:

- a. Strukturimi dhe Zonimi i Territorit;
- b. Sistemet Territoriale;
- c. Zona;
- d. Njësia;
- e. Nënnyësia;

- f. Kategorizimi i përdorimit të tokës;
- g. Kategoritë e përdorimit të tokës;
- h. Kushtëzimi për materialin hartografik të dokumentit të planifikimit.

➤ **Kreu IV - Standarde, Tregues dhe Kushtëzime në Planifikim**, i cili përmban dy seksione, si më poshtë:

1. **Seksioni 1 - Standarde dhe Tregues për Planifikimin e Territorit**, ku përcaktohen:

- a. Standardet dhe treguesit e planifikimit.

2. **Seksioni 2 - Kushtëzime Sektoriale në Planifikimin e Territorit**, ku përcaktohen:

- a. Dispozita të përgjithshme;
- b. Përdorimet industriale;
- c. Zona spitalore;
- d. Zona natyrore;
- e. Ujëra dhe ligatina;
- f. Zona bujqësore;
- g. Zonat turistike dhe parimet bazë;
- h. Zhvillimi në territoret turistike bregdetare;
- i. Zona dhe objekte të Trashëgimisë Kulturore;
- j. Antenat.

➤ **Shtojca 1 - Tabela e Kategorizimit të Përdorimit të Tokës** ku, për çdo sistem territorial, detajohen kategoritë, nënkategoritë e përdorimit të tokës dhe funksionet.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij Vendimi institucionet e ngarkuara, sipas shkallës së detyrimit që buron prej projektaktit të paraqitur për miratim, janë:

- Në nivel qendror: Këshilli i Ministrave, Këshilli Kombëtar i Territorit, Ministria përgjegjëse për çështjet e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, Ministrinë përgjegjëse për sektorët që preken nga planifikimi i territorit, Agjencia përgjegjëse për planifikimin e territorit;
- Në nivel vendor: Këshilli i Qarkut dhe Kryetari i Këshillit të Qarkut; Këshilli Bashkiak dhe Kryetari i Bashkisë.

VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Hartimi i Projektaktit, të paraqitur për shqyrtim, është realizuar nga Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë përgjegjëse për çështjet e

planifikimit dhe zhvillimit të territorit. Në hartim kanë kontribuar me sugjerime dhe komente Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Mjedisit, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës dhe Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura.

Gjithashtu kanë kontribuar dhe Bashkitë Berat, Elbasan, Kuçovë, Fier, Lushnje, Divjakë, Tiranë, Gjirokastër, Korçë, Kurbin; Krujë, Kukës, Skrapar, Poliçan, Ura Vajgurore, Cerrik, Librazhd, Prrenjas, Dibër, Shkodër, Lezhë, Rrogozhinë, Vlorë, Sarandë, Himarë, Konispol, Kavajë, Pogradec, Durrës, Shijak, Vorë, Mat, Malësi e Madhe, Tropojë, Klos, Vau Dejës, Pukë, Mirditë, Gramsh, Belsh, Përmet, Këlcyrë, Kolonjë, Dropull.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektvendim nuk do të ketë efekte shtesë financiare në buxhetin e shtetit, pasi implementimi i tij nuk do të kërkojë financime shtesë nga ky buxhet, kjo për arsye se strukturat që do të bëjnë implementimin e vendimit në praktikë, tashmë ekzistojnë prej kohësh.